

REPubLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3796/2 Prot.

Tiranë, më 20.12.2023

VENDIM

Nr. 73, datë 20.12.2023

**“PËR MIRATIMIN E TARIFËS PËR MARRJEN E TITULLIT “PROFESOR I ASOCIUAR”
DHE “PROFESOR”, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 49 dhe 61; Statutin e UMT-së, nenet 33 dhe 75; ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; VKM nr. 112, datë 23.02.2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar; Udhëzimit të MASR, nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, pika 11; në Vendimin e Senatit Akademik të UMT-së nr. 87, datë 28.07.2023 “Për miratimin e propozimit të KPPPA-së për aplikimin e tarifave për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, si dhe në Relacionin e Grupit të Punës me nr. 3078/10 prot., datë 13.12.2023, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 20.12.2023,

VENDOSI:

1. Kandidatët që kërkojnë të promovohen për të fituar titujt akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, i nënshtrohen tarifës për shërbimin e kryer në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, sipas Relacionit të Grupit të Punës nr. 3078/10 prot., datë 13.12.2023.
2. Për kandidatët të cilët janë personel akademik me kohë të plotë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, tarifa përballohet nga të ardhurat e vetë institucionit.
3. Për kandidatët të cilët vijnë nga jashtë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, tarifa përballohet nga vetë kandidati, nga institucioni nga vjen kandidati ose nga palë të treta.
4. Ky vendim zbatohet për kandidatët që do të aplikojnë për fitim të një titulli akademik, nga hyrja në fuqi e tij.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi Administratori i UMT-së, njësitë kryesore të UMT-së, si dhe Drejtoria e Kërkimit, Promovimit Akademik dhe Komunikimit pranë Rektoratit të UMT-së.
6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqet zyrtare të njësive përbërëse të UMT-së.

KRYETAR
ZAMIRA GJINI

ANETARË
VERA OSTRENI

ALTINA XHAFERI

ALBANA GJINOPULLI

ENDRIT VZEIRAJ

MONIKA FIDA
ANIS THODHORJANI